



UNIVERSITETI
BARLETI

“SALVEO
CLINIC”

Nr. 118 prot., dt. 25/01 /2023

Nr. _____ prot., dt. 29/01 /2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT “BARLETI”

DHE

“SALVEO CLINIC”

Universiteti “Barleti” i përfaqësuar nga Prof. Dr. Suzana Guxholli dhe Klinika e FIZIOTERAPISE “SALVEO CLINIC”, përfaqësuar nga Dr. Kleton Kadillari, në zbatim të kompetencave të tyre përkatëse, bien dakort të bashkëpunojnë për nxitjen e shkëmbimit të shumëanshëm në funksion të zhvillimit institucional.

Neni 1

Bashkëpunimi ndërmjet të dy institucioneve do të përfshijë:

- a. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta;
- b. Shkëmbimin e ambjenteve të përbashkëta për orë laboratorike dhe ose praktika profesionale, zyra e mjedise të tjera në varësi të nevojave dhe mundësive të dy institucioneve.
- c. Nxitjen, mbështetjen dhe realizimin e veprimtarive të tjera shkencore (konferenca, seminare e botime në fusha me interes të dyanshëm);
- d. Punësimin eventual të studentëve

Neni 2

Të dy institucionet bien dakort që realizimi i veprimtarive të mësipërme të kryhet në varësi të burimeve dhe potencialit të disponueshëm nga secili institucion. Detajimi i bashkëpunimit në fushat e mësipërme (1/a-d) dhe ndjekja e zbatimit do të realizohet nga i ngarkuari përfaqësues i secilit institucion.

Neni 3

Cdo nen i kësaj marrëveshje mund të ndryshohet, të amendohet ose të revokohet në cdo kohë pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet dy institucioneve.

Neni 4

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 3 vjeçare nga data e nënshkrimit. Ajo rinovohet automatikisht në mënyrë të heshtur, kur të dy institucionet janë dakort për këtë. Nëse njëri prej institucioneve kërkon të zgjidhë këtë marrëveshje duhet të njoftojë me shkrim jo më pak se 3 (tre) muaj përpara. Mosrinovimi i kësaj marrëveshje bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar nga institucioni i interesuar të paktën 3 (tre) muaj përpara përfundimit të saj.

Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje, në gjuhën shqipe, tekstet e saj janë autentike.

Tiranë, më 24/01/2023

REKTORI

I UNIVERSITETIT "BARLETI"

PROF. DR. SUZANA GUXHOLLI



PËRFAQËSUESI I

KLINIKËS

Dr. KLETON KADILLARI

Kleton Kadillari

